

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit ["E..."] me seli në Poloni, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokatura ["K..."] sh.p.k, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Akventimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, III.EK.nr.480/17 të datës 20.03.2018 në seancën e kolegjit me datë 26.04.2018, mori këtë :

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa paditësit ["E..."] me seli në Poloni, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.480/17 i datës 20.03.2018 **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin III.EK.nr.480/17 të datës 20.03.2018, e ka hudhur si të palejuar padinë e paditësit ["E..."] me seli në Poloni, të ushtruar kundër të paditurës Korporata Energjike e Kosovës (KEK), me seli në Prishtinë, për shkak të jo-kompetencës lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike.

Kundër këtij aktvendimi ne afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar gjykatës së shkallës së dytë që të aprovojë ankesën e paditësit dhe ta Prish aktvendimin e atakuar ashtu që lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për shqyrtim dhe vendosje meritore, si gjykatë e kompetencës lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike.

Në përgjigje në ankesë e paditura Korporata Energjike e Kosovës (KEK), i propozon gjykatës së Apelit që ankesën e paditësit të refuzojë si të pa bazuar dhe ta vërtetojë aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë si të ligjshëm.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe përgjigjen në ankesë pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK, gjeti se:

**Ankesa është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi [“E...”] me seli në Poloni, ka ushtruar padi kundër të paditurës Korporata Energjike e Kosovës (KEK), me seli në Prishtinë, me objekt konteksti pasurim i pa bazë në vlerë prej 1,987,984.27 €.

Gjykata e shkallës së parë është shpallur jo kompetente për të vendosur në këtë çështje juridike, dhe e ka hudhur poshtë padia e paditësit, pasi që palët kanë kontraktuar arbitrazhin si metodë alternative e zgjidhjes së konfliktit në mes tyre, në kontratën me shenjen ... të datës 05.08.2014, në nën pikën 20.6 përkatësisht në pikën 5.3, palët kanë përcaktuar se: “Mosmarrëveshja përfundimisht zgjidhet me arbitrazh para tribunalit (Tribunalit të Arbitrazhit), mbajtur në pajtim me rregullat e Arbitrazhit të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare të Tregtisë (UNICITRAL) ...” të gjitha procedimet e tilla të arbitrimit do të mbahet në arbitrazhin me seli në Zvicërr. Nga kjo bazë dhe konform dispozitave të nenit 391 pika (b) lidhur me nenin 20 par 1 dhe 2 të LPK-së gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë në lidhje me shpalljen jo kompetente duke u bazuar në nenin 391 lidhur me nenin 20 të LPK-së ku është përcaktuar se: *”po qe se palët për zgjidhjen e kontestit të caktuar e kanë kontraktuar arbitrazhin, gjykata të cilës i është paraqitur padia për të njëjtin kontest midis palëve të njëjta, sipas prapësimit të palës së paditur do të shpallet inkompetente, do të i anulohet veprimet e kryera në procedurë dhe do ta hedhë poshtë padinë...”*. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se palët më marrëveshje përkatësisht me nenin 20.6, në pikën 5.3 në marrëveshje, e kanë kontraktuar arbitrazhin për zgjidhjen e kontesteve në mes tyre dhe se pala e paditur me prapësimin e paraqitur në gjykatën e shkallës së parë ka kërkuar që e njëjta gjykatë të shpallet jo kompetente dhe të hudhë poshtë padinë si të palejuar duke i anuluar kështu të gjitha veprimet e ndërmarra.

Gjykata e Apelit vlerësoi pretendimet ankimore të paditësit lidhur me faktin se kërkesëpafia e paditësit ka të bëjë me punët shtesë të cilat nuk ishin paraparë me kontratën ... të dt. 05.08.2017 dhe e klauzola e arbitrazhit ka ndikim vetëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me zbatimin e detyrimeve kontraktuese nga kontrata ..., e dt. 05.08.2017 por jo edhe për punët tjera të cilat nuk ishin pjesë e asaj kontrate, por gjykata gjeti se këto pretendime janë ta pabazuara nga fakti se me Nenin 4 të Kontratës për Punime të Reja – “Remonti madhor i turbinës me avull dhe gjeneratorit elektrik Termocentrali Kosova “A” – Njësia A4 dhe njësia A5” është përcaktuar se: *“palët janë pajtuar që në të gjitha aspektet e tjera kushtet kontraktuale dhe përkufizimet e [parashikuar në Kontratën e Remonitit do të zbatohen dhe janë të përfshira siç duhet në këtë kontratë”*. Bazuar në këtë dispozitë rezulton se palët janë pajtuar që edhe mosmarrëveshjet eventuale që mund të lindin nga Kontrata për

punimet e reja, të zgjidhen sipas kushteve të përcaktuara me kontratën e parë respektivisht edhe për këtë kontratë vlen klauzola e arbitrazhit nga kontrata ..., e dt. 05.08.2017.

Bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktvendimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktvendimit dhe se aktvendimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 par. 1 pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 20 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ae.nr.102/2018 me dt. 26.04.2018**

**KRYETARI I KOLEGJIT-GJYQTARI**  
**Mahir Tutuli, dv.**

